



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE**

Nr. 871/5 prot.

Tiranë, më 22.05.2026

VENDIM

Nr. 17, datë 22.05.2026

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 871 prot., datë 27.03.2026, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Komisioni i Prokurimit Publik”, (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës për informacion datë 13.03.2026, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me tenderin me nr. REF34376-12-23-2024, me objekt: “Porti i Ri Tregtar i Integruar i Durrësit në Porto Romano – Faza I”. Konkretisht në lidhje me ankimin nga BOE “JAN DE NUL NV- SOLETANCHE BACHY INTERNATIONAL - VINCI CONSTRUCTION GEOINFRASTRUCTURE”, konkretisht:

- *Vënien në dispozicion të ankimit 970/2025 datë 14.04.2025 të operatorit si më sipër depozituar pranë institucionit tuaj.*

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 852/1 prot., datë 25.03.2026, ka kthyer përgjigje në lidhje me kërkesën për informacion, duke sqaruar ndër të tjera se: “*...Ankimi nr. 970/2025 prot., datë 14.04.2025 për procedurën e prokurimit me nr. REF-34376-12-23-2024 lidhet me*

kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (në vijim KVO), mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “JAN DE NUL NV- SOLETANCHE BACHY INTERNATIONAL – VINCI CONSTRUCTION GEO INFRASTRUCTURE, nga procedura e prokurimit të sipërcituar. Në këtë rast, duke qenë se ankesa lidhet me vendimmarrjen e KVO për skualifikimin e ankimuesit, KPP me marrjen e ankesës ka kryer veprimet paraprake në përputhje me parashikimet ligjore lex specialis duke publikuar formularin për publikim me nr. 970/1 prot., datë 15.04.2025 lidhur me arsyet e skualifikimit të ankimuesit të cilin mund ta aksesoni në faqen zyrtare të KPP-së në seksionin “Regjistri i ankesave”, si dhe në bazë të kësaj ankesë ka disponuar me vendimin nr. 549/2025 datë 23.04.2025, të cilin mund ta aksesoni në seksionin “Regjistri i vendimeve”. Sa më sipër, kërkesa juaj është në tejkalim të qëllimit të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, pasi shkon përtej veprimeve paraprake që duhet të kryhen nga KPP në rastin e ankesave për vendimin vlerësimit/klasifikimit përfundimtar dhe në këtë mënyrë KPP i qëndron strikt parashikimeve aktuale ligjore duke publikuar në rastin konkret përmes formularit për publikim vetëm arsyet e skualifikimit në përputhje me parashikimet e nenit 112 pika 3/b të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.”

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri, me shkresën nr. 871/1 prot., datë 03.04.2026, ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin lidhur me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe rivlerësimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit duke mbajtur në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të LDI, ku përcaktohet se: “*Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim*”, brenda datës 10.04.2026.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 1083/1 prot., datë 10.04.2026, ka kthyer përgjigje duke sqaruar ndër të tjera se: “*Komisioni i Prokurimit Publik, referuar nenit 24, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë*

tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij. Ashtu sikurse kemi informuar edhe kërkuuesin, në këtë rast duke qenë se ankesa lidhet me vendimmarrjen e KVO për skualifikimin e ankimuesit, KPP me marrjen e ankesës ka kryer veprimet paraprake në përputhje me parashikimet të lex specialis, konkretisht neni 112 “Veprimet paraprake” pika 3 dhe 4 e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, i cili përcakton: 3. Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, Komisioni i Prokurimit Publik publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihet pretendime. 4. Sistemi i Ankesave Elektronike në ndërveprim me Sistemin e Prokurimit Elektronik gjeneron një kod autentifikimi unik, që u vihet në dispozicion operatorëve ekonomikë të interesuar për t’u njohur me atë pjesë të ankesës, për të cilën ngrihen pretendime. Në asnjë rast Komisioni nuk jep akses në informacion të klasifikuar si sekret tregtar.” Vlerësojmë se kërkesa mbi vënien në dispozicion të ankimit nr. 970/2025 prot., datë 14.04.2025 është në tejkalim të qëllimit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar, pasi shkon përtej veprimeve që duhet të kryhen nga KPP në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar dhe në këtë mënyrë KPP i qëndron strikt parashikimeve aktuale ligjore duke publikuar në rastin konkret përmes formularit për publikim vetëm arsyet e skualifikimit në përputhje me parashikimet e nenit 112 pika 3/b të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Sqarojmë se në formularin për publikim në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, pra kur ankimuesi paraqet ankesë mbi arsyet e skualifikimit të tij nga procedura e prokurimit, për aq sa kuadri ligjor lejon ka informacion të plotë mbi numrin e referencës, objektin dhe fondin limit të procedurës së prokurimit, autoritetin kontraktor që e zhvillon procedurën, ankimuesin dhe arsyet e skualifikimit të tij të shkëputura literalisht nga raporti i auditit në sistemin e ankesave elektronike. Për aq sa kuadri ligjor sektorial lejon edhe vetë operatorët ekonomikë të interesuar të cilat në kuptim të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, janë operatorët ekonomikë, që kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cënohen nga ankesa e paraqitur, e aksesojnë ankesën vetëm përmes publikimit në formularin për publikim të arsyeve të skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar ose pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen këto pretendime. KPP gjen me vend të theksojë gjithashtu se, ndërsa çdo subjekt i ligjit për prokurimin publik dhe jo vetëm, ka të drejtë të interpretojë dispozitat e këtij legjislacioni, po ashtu, këto subjekte kanë edhe detyrimi ta interpretojnë atë në përputhje e harmoni të brendshme dhe të jashtme me legjislacionin tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë. KPP në cilësinë e organit më të lartë në fushën e prokurimit publik, ka të drejtën dhe përgjegjësinë të bëjë interpretimin përfundimtar të legjislacionit të fushës përkatëse. Duke e parë në këtë këndvështrim KPP i qëndron strikt parashikimeve aktuale ligjore duke publikuar/dhënë informacion për subjektet e ligjit të prokurimit publik dhe jo vetëm, në rastin konkret përmes formularit për publikim vetëm mbi

arsyet e skualifikimit në përputhje me parashikimet e nenit 112 pika 3/b të ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar. Çdo informacion tjetër mbi përmbajtjen e ankesës në rastin e ankesave për vlerësimin e ofertave në një procedurë prokurimi në tejkallim të asaj që është parashikuar më sipër mund të çënojë sekretin tregtar apo të dhëna të tjera në kuptim të ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", ku përpunimi i tyre është i ndaluar për sa kohë subjekti i të dhënave nuk ka dhënë shprehimisht pëlqimin për përpunimin e tyre."

Pas përgjigjes së sipërcituar, me e-mail-in datë 20.04.2026, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 871/3 prot., datë 20.04.2026, ankuesi ka vijuar ankimin me pretendimin se: "Qëndrimi i KPP-së bazohet në një qasje përjashtuese dhe në kapërcim të kompetencave të saj ligjore, duke tentuar të asgjësojë plotësisht Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Argumentet e KPP-së janë të pabazuara për arsyet e mëposhtme:

Në faqen 3 të shkresës, KPP thekson se si "organi më i lartë në fushën e prokurimit publik, ka të drejtën dhe përgjegjësinë të bëjë interpretimin përfundimtar të legjislacionit... në harmoni me legjislacionin tjetër". KPP është organi më i lartë administrativ për procedurat e prokurimit, por nuk është autoriteti që interpreton përfundimisht Ligjin "Për të drejtën e informimit". Harmonizimi i ligjeve nuk do të thotë që ligji sektorial (prokurimet) të asgjësojë ligjin e transparencës (informimi). Kompetenca për të vlerësuar nëse një dokument i kërkuar nga publiku duhet të jepet ose jo—dhe balancimi i kësaj me sekretin tregtar—i takon pikërisht institucionit Tuaj (Komisionerit) dhe gjykatave, jo vullnetit të njëanshëm të KPP-së. KPP argumenton se përderisa vetë operatorët ekonomikë (konkurrentët në tender) kanë akses vetëm në përmbledhjen e arsyeve të skualifikimit, e njëjta gjë vlen edhe për publikun. Ky argument është i pavlefshëm. Kufizimi i aksesit mes operatorëve ekonomikë gjatë procedurës ka për qëllim mbrojtjen e konkurrencës, shmangien e marrëveshjeve të fshehta (koluzionit) ose vjedhjen e specifikimeve teknike mes rivalëve. Kërkesa ime si gazetar nuk bëhet në cilësinë e një konkurrenti në tender, por në emër të interesit publik për të mbikëqyrur se si institucionet shtetërore trajtojnë ankesat e operatorëve (sidomos konsorciumeve ndërkombëtare) për përdorimin e fondeve publike. Në paragrafin e fundit, KPP ngre si justifikim të ri Ligjin nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Ankuesi në fjalë është një bashkim operatorësh ekonomikë ("JAN DE NUL NV...", etj.), pra persona juridikë. Personat juridikë nuk gëzojnë mbrojtje të "të dhënave personale" në kuptimin e ngushtë që pengon publikimin e një anese administrative, pasi veprimtaria e tyre lidhur me fondet publike është tërësisht e hapur. Për më tepër, edhe nëse supozojmë se në tekstin e ankimit prej disa faqesh ka detaje të veçanta teknologjike që përbëjnë "sekret tregtar" ose të dhëna sensitive të individëve (p.sh. numra telefoni të përfaqësuesve), KPP refuzon me kokëfortësi të zbatojë Nenin 17 të Ligjit 119/2014 (Informacioni i Pjesshëm). Autoriteti publik e ka detyrim ligjor që të mbulojë/redaktojë vetëm ato fjali që përbëjnë sekret tregtar dhe të vërë në dispozicion pjesën tjetër të dokumentit (argumentet juridike dhe pretendimet për shkelje ligjore nga KVO). Refuzimi i dhënies së të gjithë dokumentit në bllok tregon mungesë vullneti për transparencë, jo mbrojtje të ligjit. KPP po e përdor "publikimin proaktiv" (hedhjen e një përmbledhjeje në sistem) si pretekst për t'iu shmangur dhënies së

llogarisë dhe transparencës së plotë kur ajo i kërkohet nominalisht. Publikimi i disa "arsyeve mot à mot të nxjerra nga sistemi" nuk e zëvendëson dokumentin e plotë të ankimit, i cili përmban logjikën juridike, provat dhe pretendimet e plota të një kompanie kundër shtetit.

Duke theksuar interesin e lartë publik që ka kjo procedurë prokurimi, mbetem me besim se institucioni Juaj do të urdhërojë Komisionin e Prokurimit Publik të vërë në dispozicion dokumentin e kërkuar, duke kryer redaktimet përkatëse vetëm nëse është rreptësisht e nevojshme dhe e provueshme.”

Pas përgjigjes së sipërcituar, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se: *“...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”,* bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri çmoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore, e cila u zhvillua me datë 19.05.2026 me praninë e ankuesit dhe përfaqësueses së Autoritetit Publik. Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesën fillestare, si dhe vijimin e saj. Gjithashtu, përfaqësuesja e Autoritetit Publik rikonfirmoi qëndrimin e mbajtur në aktet shkresore të sipërcituara.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”.* Në kuptim të këtij parashikimi, Komisioni i Prokurimit Publik është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.”*

Në argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik se, *“KPP i qëndron strikt parashikimeve aktuale ligjore duke publikuar apo dhënë informacion për subjektet e ligjit të prokurimit*

publik vetëm përmes formularit për publikim duke referuar arsyet e skualifikimit në përputhje me nenin 112 pika 3/b të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”, Komisioneri vlerëson se, ky pretendim nuk qëndron. Autoriteti Publik në zbatim të legjislacionit të posaçëm dhe veprimtarisë së tij ka detyrimin për të bërë transparencë proaktive duke publikuar formularin e ankimit bazuar referencës ligjore sikurse parashtron, por ligji i sipërcituar nuk e ndalon në asnjë dispozitë të tij bërjen publike të ankesës në kushtet kur ka një kërkesë për informacion nga operatorët apo çdo qytetar i interesuar për t’u njohur me dokumentacionin e plotë objekt shqyrtimi.

Thënë kjo, vlen të theksojmë se LDI, edhe pse jo shprehimisht, bën një kategorizim të informacionit të aksesueshëm nga publiku në dy kategori kryesore: 1) *informacioni që bëhet publik pa kërkesë dhe 2) informacioni që vihet në dispozicion pas kërkesës së subjektit të interesuar*. Në kategorinë e parë, përfshihen ato kategori informacioni, përcaktuar në nenin 7 të LDI, të cilat publikohen dhe vihen në dispozicion nga Autoriteti Publik, pa qenë i nevojshëm angazhimi i ndonjë subjekti, ndërsa rasti konkret objekt shqyrtimi, i përket kategorisë së dytë, që përfshin ato informacione për njohjen e të cilave është e nevojshme të paraqitet një kërkesë për informim pranë Autoritetit Publik, në përputhje me parashikimet e nenit 11 e vijues të LDI, detyrim të cilin Autoriteti Publik nuk e ka përmbushur.

Për më tepër, fryma e përgjithshme e legjislacionit të sipërcituar është të sigurojë integritet, besim në publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik, nga ana e Autoriteteve Publike, duke bërë publike sa më tepër informacion që lidhet me këto procedura dhe jo duke e kufizuar atë.

Vetë ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 2 të tij përcakton se një nga qëllimet e tij është që të sigurojë transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ndërkohë, në nenin 3 mbi parimet e përgjithshme të tij parashikohet që, ndër të tjera, autoritetet dhe entet kontraktore veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Edhe neni 18 parashikon në pikën 1 të tij se prokurimi publik duhet të zhvillohet në mënyrë transparente me paanshmëri dhe pa asnjë trajtim preferencial. Transparenca në këtë ligj rregullohet edhe nga pika 4 e nenit 16, e cila parashikon se: *“Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në legjislacionin e brendshëm, në veçanti legjislacioni në fuqi për të drejtën e informimit, dhe pa cenuar detyrimet që lidhen me publikimin e kontratave të dhëna dhe me informimin e kandidatëve dhe ofertuesve sipas parashikimeve në këtë ligj, autoriteti ose enti kontraktor nuk bën publike informacionet e dërguara nga operatorët ekonomikë, të cilët këta të fundit i kanë përcaktuar si konfidenciale, duke përfshirë, por pa u kufizuar me sekrete teknike ose tregtare dhe aspekte konfidenciale të ofertave”*.

Sa më sipër, dispozitat e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, duhet të lexohen në harmoni jo vetëm me LDI, por edhe me vetë parashikimet e tij. Të gjitha dispozitat e mësipërme, theksojnë nevojën për transparencë gjatë procesit. Në mënyrë të veçantë, duhet të vlerësohet raporti që vetë ky ligj, në nenin 16, ka krijuar me LDI duke njohur shprehimisht

mundësinë e rregullimeve të ndryshme nga legjislacioni i brendshëm dhe zbatueshmërinë e tij. Togfjalëshi “në legjislacionin e brendshëm, në veçanti legjislacioni në fuqi për të drejtën e informimit” nënkupton jo vetëm që ky ligj nuk përjashton zbatimin e LDI, por njëkohësisht njeh dhe parashikon zbatimin e një game tjetër legjislacioni të brendshëm, ku ndër më të rëndësishmit përmendim parashikimet e nenit 23 të Kushtetutës dhe ligjin nr. 45/2022 Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare”.

Në këto kushte, Autoriteti Publik nuk mund të pretendojë zbatimin strikt vetëm të nenit 112 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, duke anashkaluar dispozitat e tjera të po këtij ligji, të LDI apo legjislacionit të brendshëm në tërësi mbi të drejtën për informim.

Në interpretim *a contrario* dhe në vijim të qëndrimit të Autoritetit Publik, duke qenë se dispozita e sipërcituar parashikon shprehimisht vetëm detyrimet që lidhen me publikimin e kontratave, atëherë çdo dokumentacion/informacion tjetër i parashikuar nga LDI apo i dërguar nga operatorët ekonomikë, nuk duhet të vihet në dispozicion të publikut. Si pasojë, edhe parashikimet e nenit 7 të LDI i cili përcakton publikimin në Programin e Transparencës të informacionit mbi procedurat e prokurimit¹, do të ishin të pazbatueshme.

Neni 16 i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcakton edhe një hallkë tjetër vlerësimi që Autoriteti Publik duhet ta mbajë në konsideratë gjatë vlerësimit të kërkesës për informacionin e kërkuar, në rastin konkret, ankesën e një operatori ekonomik. Kjo pasi vetë dispozita e sipërcituar parashikon se detyrimi i Autoritetit Publik është që të mos publikojë atë informacion të dërguar nga operatorët ekonomikë, të cilët këta të fundit i kanë përcaktuar si konfidenciale, duke përfshirë, por pa u kufizuar me sekrete teknike ose tregtare dhe aspekte konfidenciale të ofertave. Gjatë të gjithë procedurës së shqyrtimit të ankesës, as në parashtrime dhe as në seancë dëgjimore, Autoriteti Publik nuk ka përmendur dhe as nuk ka paraqitur fakte që të provojnë se operatori ekonomik ka përcaktuar si konfidenciale ankesën në tërësinë e saj. Në këto kushte, ankesa e paraqitur nga një operator ekonomik nuk mund të përbëjë në vetvete një informacion sekret tregtar.

Sa i përket pretendimeve të Autoritetit Publik se, *“Çdo informacion tjetër mbi përmbajtjen e ankesës në rastin e ankesave për vlerësimin e ofertave në një procedurë prokurimi mund të cënojë sekretin tregtar apo të dhëna të tjera në kuptim të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ku përpunimi i tyre është i ndaluar për sa kohë subjekti i të dhënave*

¹ Shkronja “ë” e pikës 1 të këtij neni parashikon publikimin e informacionit për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” të ndryshuar, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë:

- i) listën e kontratave të lidhura;
- ii) shumën e kontraktuar;
- iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;
- iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

nuk ka dhënë shprehimisht pëlqimin për përpunimin e tyre”, Komisioneri vlerëson se këto argumente sërisht nuk qëndrojnë.

Pretendimi se ankesa e operatorit ekonomik nuk mund të bëhet publike për shkak të pranisë së të dhënave personale është i pabazuar, pasi jo çdo informacion i përfshirë në një ankesë përbën “të dhënë personale” në kuptim të pikës 3 të nenit 5, të ligjit nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, e cila përcakton se: *“E dhënë personale” është çdo informacion në lidhje me një subjekt të dhënash*, si dhe pikës 23 të tij që përcakton se: *“Subjekt i të dhënave” është çdo person fizik i identifikuar ose i identifikueshëm. Një person është i identifikueshëm nëse mund të arrihet në identifikimin e tij, duke iu referuar drejtpërdrejt ose tërthorazi një apo disa faktorëve identifikues të veçantë, si: emri, numri i identifikimit, të dhënat për vendndodhjen, një identifikues në internet, ose një apo më shumë faktorëve specifikë, lidhur me identitetin e tij fizik, fiziologjik, identitetin gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror. Përmbajtja e ankesës lidhet kryesisht me argumente procedurale, juridike dhe ekonomike që burojnë nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi publik dhe nuk identifikojnë apo prekin jetën private të personave fizikë.*

Edhe në rastin kur dokumentacioni do të përmbante elemente të kufizuara të të dhënave personale, pika 2 e nenit 44 të ligjit të sipërcituar parashikon se: *“Aksesi i publikut në informacionin publik, siç përcaktohet në ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, dhe aksesit i publikut në informacionin që lidhet me kryerjen e funksioneve dhe të detyrave zyrtare, nuk pengohet nga e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale të personave fizikë, të cilët konsiderohen si autoritete publike ose ushtrojnë funksione shtetërore, përveç rasteve kur të drejta të tjera themelore, si e drejta e tyre për jetën ose e drejta e tyre për integritet fizik e mendor kërkojnë mbrojtjen e të dhënave të tyre në një rast ose kategori të caktuar rastesh”*. Pra, aksesit në informacion publik nuk pengohet nga e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale, çka imponon anonimizimin e të dhënave personale dhe jo refuzimin e plotë të dokumentit.

Sa më sipër, konstatohet se, Autoriteti Publik në argumentin e parashtruar për mos dhënie të informacionit, nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë apo të argumentojë se si kjo e drejtë kufizohet, kur është e domosdoshme, proporcionale, si dhe dëmin që mund t’u shkaktojë bizneseve/kompanive si pasojë e dhënies së informacionit të kërkuar.

Ndërkohë referuar pretendimeve mbi mbrojtjen e sekretit tregtar, sillat në vëmendje se neni 2, pika 3/1 e LDI ka përcaktuar përkufizimin e sekretit tregtar duke i dhënë atij të njëjtin kuptim që i ka dhënë ligji nr. 9947 date 7.7.2008 “Për pronësinë industriale” i ndryshuar. Konkretisht, në nenin 111/a të tij parashikohet se:

“1. “Sekreti tregtar” është informacioni që përmbush kërkesat e mëposhtme:

a) është sekret në kuptimin që në tërësinë e tij ose për sa i përket konfigurimit të saktë dhe kombinimit të pjesëve përbërëse të tij, nuk është gjerësisht i njohur ose lehtësisht i aksesueshëm për personat që përgjithësisht merren me llojin e informacionit në fjalë;

b) ka vlerë tregtare, sepse është sekret;

c) u është nënshtruar hapave të arsyeshëm për ruajtjen e informacionit, sipas rrethanave, nga personi që zotëron në mënyrë të ligjshme informacionin për të mbajtur sekretin të fshehtë.

2. Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, me informacion dhe hapa të arsyeshëm për ruajtjen e informacionit do të kuptojmë:

a) informacioni i referuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni përfshin, ndër të tjera, njohuritë teknike, informacionet për shoqërinë tregtare dhe informacionet teknologjike;

b) informacioni i referuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni ka vlerë tregtare, ndër të tjera, në ato raste kur përvetësimi, përdorimi ose bërja publike e paligjshme e sekretit tregtar ka mundësi të dëmtojë interesat e personit që kontrollon në mënyrë të ligjshme këtë sekret tregtar, duke cenuar potencialin e tij shkencor dhe teknik, interesat financiare të shoqërisë tregtare, pozicionet strategjike ose mundësinë për të konkurruar;

c) hapat e arsyeshëm të referuar në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij neni mund të përfshijnë përgatitjen e një akti të brendshëm për administrimin e një sekreti tregtar dhe grupin përkatës të personave, që është përgjegjës për administrimin e tij apo masat për mbrojtjen fizike ose virtuale në aksesin e administrimin e sekretit tregtar.

3. “Mbajtës i sekretit tregtar” është çdo person fizik ose juridik që zotëron në mënyrë të ligjshme një sekret tregtar”

Ndërkohë, në nenin 18 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, është përcaktuar qartë kufiri i sekretit tregtar, i cili përfshin vetëm informacionin e brendshëm. Megjithatë, në pikën 2 të nenit 18 të këtij ligji parashikohet se: “2. Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkëlqen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik”.

Në kuptim të dispozitave të mësipërme, si LDI ashtu edhe ligjet e sipërcituara, në asnjë rast nuk parashikojnë një kufizim absolut të vendosjes në dispozicion të informacionit që zotëron një Autoritet Publik, por ai vlerësohet duke synuar ruajtjen e një balance të drejtë midis informimit të publikut dhe ruajtjes së sekretit tregtar të subjekteve private.

Duke qenë se ankesa lidhet me një procedurë prokurimi publik dhe me përdorimin e fondeve publike, mbizotëron një interes i lartë publik për transparencë dhe llogaridhënie. Pretendimi për “sekret tregtar” nuk mund të jetë abstrakt apo *blanket*, por duhet të justifikohet në mënyrë konkrete dhe proporcionale për secilën pjesë të informacionit të kufizuar.

Për rrjedhojë, në mungesë të një dispozite të posaçme ligjore për të legjitimuar diskrecionin e Autoritetit Publik, për të kufizuar të drejtën për informim të publikut, nëpërmjet parashikimeve të klauzolave kufizuese dhe përjashtuese, Komisioneri vlerëson se ekzistenca e informacionit/dokumentacionit, pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të

informacionit të kërkuar, duke mbajtur në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të LDI, ku përcaktohet se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuar. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Gjithashtu, kërkuar/ankuesi është gazetar, i cili synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik. Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen *“Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë”*, vlerësoi se, pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e “mbikqyrësit shoqërorë”, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

Në përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përfundimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike. Bazuar në pikën 3, të nenit 3 të LDI, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 871 prot., datë 27.03.2026, (vijuar me nr. 871/3 prot., datë 20.04.2026) të z. kundër Autoritetit Publik “Komisioni i Prokurimit Publik”, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 13.03.2026, konkretisht: (*“Vënien në dispozicion të ankimit 970/2025 datë 14.04.2025 të operatorit BOE “JAN DE NUL NV- SOLETANCHE”*

BACHY INTERNATIONAL - VINCI CONSTRUCTION GEOINFRASTRUCTURE, në lidhje me tenderin me nr. REF34376-12-23-2024, me objekt: “Porti i Ri Tregtar i Integruar i Durrësit në Porto Romano – Faza I”), brenda datës 03.06.2026.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 22.05.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi